



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe nenit 19 par. 19.4 pika d) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2025, miratoi këtë:

PROPOZIM

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS  
SË LIPJANIT PËR VITIN 2026**

**Neni 1**

**MIRATOHET** Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

**Neni 2**

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Neni 3**

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

|              |                                                                                                                  |
|--------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| JANAR 2026   | Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2026                                           |
|              | Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2025             |
|              | Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)                             |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
| SHKURT 2026  | Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual                                  |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
|              | Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak |
|              | Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor                                                      |
| MARS 2026    | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
|              | Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2025                                                   |
| PRILL 2026   | Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2026                           |
|              | Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre                                                    |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
| Maj 2026     | Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-se                                                                 |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
|              | Informatë mbi punën e komiteteve funksionale                                                                     |
| QERSHOR 2026 | Miratimi i Korrnizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029                                                               |
|              | Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2026                                                                   |
|              | Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së                                                  |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
|              | Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit                                                                  |
| KORRIK 2026  | Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2026                                   |
|              | Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2025                                     |
|              | Informatë mbi Raportin e Performancës                                                                            |
|              | Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor                                                                       |
|              | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                             |
| GUSHT 2026   | Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve                                                         |
|              | Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                              |
|              | Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se                                                                 |

|               |                                                                                                              |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| SHËTATOR 2026 | Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2027                                                  |
|               | Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027                               |
|               | Informata mbi fillimin e vitit të ri shkollor                                                                |
|               | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                         |
|               | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë                                                    |
|               | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale                                                      |
| TETOR 2026    | Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2026                                |
|               | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                         |
| NËNTOR 2026   | Informata e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore |
|               | Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                         |
|               | Informata e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi të mbjellurat                           |
| DHJETOR 2026  | Informata mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2027                                                        |
|               | Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal                                          |
|               | Informata mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2027                                                   |
|               | Shqyrtimi i raportit (informates) rreth aktiviteteve të KKS-së                                               |
|               | Informata nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport                                                          |
|               | Informata mbi funksionimin e këshillave lokale                                                               |

#### Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

#### Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

## Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

## Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë plan është e percaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe nenit 19 par.19.4 pika d) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021.

Nga të cekurat kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026.

## KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

15Nr. 020/01-67463  
Lipjan, 10.12.2025

KRYESUESI I KUVENDIT  
Daut Azemi

